



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2021:158350  
Datë: 30.03.2023  
Numri i dokumentit: 04141764

**E.nr.990/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: S.Sh., N.J., Z.Q., F.H. dhe K.V., të cilët i përfaqëson av Abdurrahim Islami nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt-Drejtorja e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 30.03.2023, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.990/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.990/22, të datës 02.09.2022, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtorja e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:158350, të datës 28.06.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 13.01.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,329.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.990/22, më datë 30.03.2023**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**